



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 168, datë 03.11.2023



PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 36, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET Z. ENDËRI KUÇI, NR. 31, DATË 03.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. ILMI TAFI, NR. 62, DATË 17.03.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. ENKELEJDA GORGEJA, NR. 61, DATË 28.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. AGIM SINA, ZNJ. SHPRESA SINA DHE Z. ERVIN SINA, NR. 37, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET Z. BESNIK ÇELPICA, NR. 30, DATË 26.03.2021 PËRSA I PËRKET ZNJ. ZIBUSH MUSTAFA, NR. 73, DATË 20.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. ISMET GJUZI, NR. 30, DATË 03.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. MUHARREM DERVISHI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në Njësinë Administrative Rrashbull, rruga “Gjon Kastrioti” pallati nr. 39, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 31, datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në Njësinë Administrative Katund i Ri, rruga “Bisht Kamëz” pallati nr. 29, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës

26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 62, datë 17.03.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 4, rruga “Aleksandër Goga” pallati nr. 120, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 3, rruga “Hysen Kërtusha” pallati nr. 32, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit për pallatin nr. 1032, rruga “Aleks Komneni” dhe pallatin “Kastrati”, rruga “Ramadan Veliu” të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 73, datë 20.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Rindërtimit në Njësinë Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga Programi i Procesit të Rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në Njësinë Administrative Katund i Ri, rruga “Bisht Kamëz” pallati nr. 27, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, si dhe Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të Kryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 09.05.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Endëri Kuçi në masën e strukturës së njësisë së banimit 1+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 31, datë 03.02.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Ilmi Tafa në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 62, datë 17.03.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të znj. Enkelejda Gorgeja në masën e strukturës së njësisë së banimit 1+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
4. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të Agim Sina, Shpresa Sina dhe Ervin Sina në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.

5. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 09.05.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues z. Besnik Çelpica në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 2+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
6. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 përsa i përket klasifikimit si përfituese të znj. Zibush Mustafa në masën e strukturës së njësisë së banimit 1+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
7. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 73, datë 20.07.2020 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Ismet Gjuzi në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
8. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 03.02.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Muharrem Dervishi në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 06.11.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 709 / prot.
8

Durrës, më 13.11.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

BASHKIA DURRËS
13.11.23 10222/7

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.168 datë 03.11.2023 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimet e këshillit bashkiak nr.36, datë 09.05.2022 përsa i përket z.Endëri kuçi, nr.31, datë 03.02.2023 përsa i përket z.Ilmi Tafa, nr 61 datë 17.03.2023, përsa i përket znj. Enkelejda Gorgeja, Nr. 61 datë 28.02.2023, përsa i përket z. Agim Sina, Znj.Shpresa Sina dhe Z. Ervin Sina, nr.37 datë 09.05.2022 përsa i përket z.Besnik Çelpica, nr.30 datë 26.03.2021 përsa i përket znj.Zibush Mustafa nr.73 datë 20.07.2020 përsa i përket z.Ismet Gjuzi, nr. 30 datë 03.02.2023 përsa i përket z. Muharrem Dervishi ”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMIEJAN JANI

